

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datede / Izlaze: Date / Dana. 22 / 06 / 2026		
Nr. Org. Org. Id. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 173	Nr. Faqeve. Br. Strana. 5
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga takimi i parë publik i Kryetarit Agim Aliu, ku u diskutua edhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2027–2029

Me datën 17 Qershor, është mbajtur takimi i parë publik i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ku pjesë e takimit ishin edhe drejtorë të drejtorive komunale, kryetar të fshatrave dhe zonave urbane, mediat dhe shoqëria civile.

Njoftimi për mbajtjen e takimit publik është publikuar me 29.05.2026 në uebfaqe të komunës në vegzën:

<https://ferizaj.rks-gov.net/ep-content/uploads/2026/05/NJoftimi-shqip.pdf>

Në këtë takim publik të pranishëm ishin: Agim Aliu-Kryetar i Komunës së Ferizajt, Kemajl Emini-Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Festina Sadiku -drejtor i Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit, Alberton Sahiti-drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Afrim Llabjani-Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Burim Bajrami-Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Meriton Hajdini-Drejtor i Infrastrukturës si dhe Balton Dërguti- Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Me datën 17 qershor duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës, është mbajtur takimi i parë publik i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu për të raportuar punën gjashtëmujore të këtij vitit si dhe për të diskutuar edhe për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Në këtë takim publik kanë marrë pjesë 34 qytetarë 5 femra dhe 29 meshkuj.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka mbajtur të mërkurën takimin e parë publik me qytetarët, ku u diskutuan të arriturat, sfidat dhe projektet e realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, si dhe Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027-2029.

Takimi mbledhi një numër të madh qytetarësh, përfaqësues të fshatrave dhe zonave urbane, të cilët për disa orë diskutuan dhe parashtruan pyetje e shqetësime lidhur me nevojat dhe prioritetet e komuniteteve të tyre. Gjatë diskutimit u theksuan investimet e realizuara nga Komuna e Ferizajt në të gjitha fshatrat dhe zonat urbane, për të cilat përfaqësuesit lokalë shprehën falënderime për qeverisjen komunale.

Në hapje të takimit, kryetari Aliu i informoi të pranishmit për punët dhe projektet e realizuara, si dhe për aktivitetet që kanë shënuar gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Ai theksoi se Komuna ka vazhduar me përmbushjen e zotimeve dhe planifikimin financiar, si pjesë e angazhimeve ndaj qytetarëve. Aliu përmendi edhe sfidat buxhetore me të cilat është përballur komuna, duke thënë se për shkak të procedurave përmbimore janë marrë rreth 3.5 milionë euro, por pavarësisht kësaj janë realizuar projekte të rëndësishme për qytetarët ferizajas.

"Neredimja u bë me shkollë të re dhe moderne, rregulluam fushën sportive model me gjithë infrastrukturën përcjellëse në shkollën 'Jeronim de Rada', ndërsa nisëm projektin 'Green Schools Initiative' në Ferizaj, ku Gjimnazi 'Kuvendi i Arbërit' është përfitues i investimeve në efikasitet të energjisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Po ashtu, diplomoi gjenerata e parë e mësimit dual, ku përmes kësaj forme moderne të arsimit nxënësit kanë përfituar njohuri dhe aftësi profesionale përmes përvojës praktike në kompani, duke u përgatitur më mirë për tregun e punës", u shpreh Aliu.

Ai u ndal edhe te përrurimi i parkut të ri në Varosh, në kuadër të projektit për krijimin e infrastrukturës turistike, i realizuar në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

"Po ashtu, kemi përfunduar parkun në Neredime, ku janë realizuar investime të shumta për rivitalizimin e tij, përfshirë fushën sportive, shtigjet e ecjes dhe vrapimit, hapësirat për qëndrim dhe rekreacion, si dhe urat që lidhin dy anët e lumit. Kemi mbjellë qindra drunjtë dekorativë dhe lule në rrethrotullime, parqe ekzistuese dhe hapësira të tjera publike. Falë projekteve dhe nismave të shumta në fushën e mjedisit, Ferizaj është renditur i pari ndër komunat e mëdha në Indeksimin e Komunave, bazuar në masat e ndërmarra për mjedisin dhe eficiencën e energjisë për vitin 2025, sipas vlerësimit të Atlas Institute", tha Aliu.

Ai i njoftoi të pranishmit edhe për nënshkrimin e disa memorandumeve të bashkëpunimit.

"Kemi nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Fondacionin Sheikha Fatima Bint Mubarak për Gruan, përmes të cilit do të ofrohen falas trajnime dhe kurse të ndryshme për vajzat dhe gratë e Ferizajt, si kurse të gjuhës angleze, teknologji informative, rrobaqepësi, menaxhim të ndërmarrjeve të vogla, pastičeri e fusha të tjera.

Po ashtu, bashkë me GIZ-in për Kosovë kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, përmes së cilës Ferizaj bëhet pjesë e programeve të trajnimit, mentorimit, rrjetëzimit dhe mbështetjes së bizneseve të udhëhequra nga gratë", tha ai.

Kryetari përmendi gjithashtu investimet e realizuara në sektorët e shëndetësisë, bujqësisë, zhvillimit ekonomik dhe turizmit, si dhe në kulturë, rini dhe sport.

Në pjesën e fundit të takimit, Aliu prezantoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, duke theksuar se për vitin 2027 është planifikuar një buxhet total prej 56,102,329 euro. Nga kjo shumë, 15.2 milionë euro janë të dedikuara për investime kapitale, rreth 2.88 milionë euro për



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

subvencione, 1.45 milionë euro për shpenzime komunale, 12.05 milionë euro për mallra dhe shërbime, ndërsa 24.51 milionë euro për paga dhe mëditje.

Qytetarët e pranishëm vlerësuan lart punën dhe angazhimin e kryetarit Aliu, duke shprehur mirënjohje për projektet e realizuara. Gjatë diskutimit, ata parashtruan një sërë kërkesash, përfshirë rregullimin e rrugëve dhe trotuareve, shtrimin me zhavorr të rrugëve bujqësore, përmirësimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimin e fushave sportive, si dhe rregullimin e parqeve publike.

Sadik Qerimi-Koshare

- Të bëhet vendosja e shenjave për kalimtarët e rastit
- Të shtrohen rrugët më zhavorr-rrugët e arave
- Të bëhet një cërdhe në fshatin tonë

Sabedin Mustafa-Pleshinë

- Vendosja e një muri mbrojtës tek salla sportive në Pleshinë
- Pastrimi i një pjesës së fshatit nga një deponi ilegale e mbeturinave
-

Visar Islami -Talinovc i Jerlive

- Të bëhet asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve të fshatit

Njazi Cakolli- Zaskok

- Rregullimi i rrugëve të fshatit
- Rregullimi i rrjetit të kanalizimit tek lagja Blenisht



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Taip Bytyqi-Mirash

- Rruga Mirash-Babush, po realizohet me probleme të shumta
- Rrugët e arave të shtrohen më zhavorr
- Ambulanta e fshatit të funksionalizohet

Njazi Behluli-Talinovc i Muhaxherëve

- Të bëhet rregullimi i ujit në fshatin tonë dhe çështja e kanalizimit

Flamur Sadiku-Fusha e Madhe

- Të bëhet ndriçimi publik në fshatin tonë
- Të bëhet edhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit

Pyetjeve dhe kërkesave të qytetarëve në fund ju kanë përgjigje drejtorët e drejtorive, por edhe Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu.

Takimi publik ka përfunduar në orën 12:00.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli-Rexhepi